



Komisioni për Implementimin e Rindërtimit  
për lokacionet religjioze Ortodokse në Kosovë

**KOMUNIKATË PËR SHTYP – 12 prill 2006**

## **TAKIMI PRELIMINAR KOORDINUES I KOMISIONIT PËR IMPLEMENTIMIN E RINDËRTIMIT**

Takimi preliminar koordinues i Komisionit për Implementimin e Rindërtimit është mbajtur të hënën me 10 prill 2006. Në takim kanë marrë pjesë Peshkopi Teodosije (përfaqësues i Kishës Ortodokse Serbe në Komision) dhe Ministri Astrit Haraqija (Ministër i Kulturës, Rinisë dhe Sporteve). Në takim gjithashtu ishin prezent anëtarët e Komisionit, përfaqësuesit e UNMIK-ut, Këshillit të Evropës, takimi kryesohej nga Znj Emma Carmichael.

Të gjitha çështjet në lidhje me pagesat nga viti 2005 janë diskutuar nga Komisioni dhe MKRS ka konfirmuar se këto çështje do të merren në konsiderim me urgjencë në bashkëpunim me Komisionin.

Pritet që riparimi i kulmit të Kishës së Nënës së Shenjtë të Zotit Ljeviska në Prizren do të tenderohen në javët në vazhdim. Komisioni do të takohet zyrtarisht gjatë javës së dytë të majit pas aprovimit të Termave të ndryshuar të Referimit. Në takim do të merremi vesh dhe do ta shpallim një program të propozuar të punëve për rindërtimin e kishave Ortodokse Serbe, posaçërisht brenda rajoneve të Prishtinës dhe Prizrenit.

Punët e vazhdueshme të Komisionit për Implementimin e Rindërtimit është e përkrahur nga Komisioni Evropian, Këshilli i Evropës, IPVQ-të dhe UNMIK-u dhe i është dhënë përkrahje shtesë nga Agjencia Evropiane për Rindërtim për dy lokacione religjioze në Prizren.



Zyra e Sekretariatit të KIE në Kosovë, Ndërtesa UNHCR HQ, kati i 6, Kragujevci 8, 10000 Prishtinë, Kosovë  
Tel : +381 (0) 38 243- 749 / 750 / 751 - Fax : +381 (0) 38 243 752

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Dhoma 132, Nëna Terezë Nr. 35, Prishtinë, 10000, Kosovë  
Tel: +381 (0)38 20022- 054 / 059/ 073 - Fax: +381 (0)38 200 220 62